

Asistencë dhe ndihmë e përgjithshme

Përshkrimi

- Ruajtja e interesave të shtetasve shqiptarë, persona fizikë dhe juridikë, në lidhje me trashëgimitë në territorin e shtetit të vendqëndrimit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e atij shteti;
- Ruajtja, brenda kufijve të caktuara nga ligjet dhe rregulloret e shtetit të vendqëndrimit, të interesave të të miturve dhe të të paaftëve, shtetas shqiptarë, sidomos kur për ta kërkohet vendosja e një kujdestarie;
- Rekomandimi i avokatëve kur shtetasi shqiptar ka nevojë apo i përkthyesve të licencuar
- Sqarimi i shtetasve shqiptarë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që u dalin bazuar në legjislacionin e vendit

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Një dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Dokumenti origjinal dhe i legalizuar për rastet e trashëgimisë, të interesave të të miturve dhe të paaftëve apo paraqitja e shtetasit tek konsulli për asistencë të ndryshme.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht ose me postë e problematikës;
- 2) Verifikimi i identitetit të personit të interesuar, nëse është e nevojshme;
- 3) Veprimet e ndërmjetësimit të nëpunësit konsullor me autoritetet e vendit pritës;
- 4) Njoftimi i rezultateve të ndërmjetësimit, personave të interesuar.

Tarifa e shërbimit dhe afati

Pa tarifë

Në varësi të rrethanave.

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Postet konsullore mbajnë një listë të avokatëve dhe përkthyesve të licencuar në juridiksionit që mbulojnë.

Konsujt kanë informacionin e nevojshëm mbi legjislacionin vendas për t'i udhëzuar shtetasit tanë për probleme të ndryshme.